



Datë:14.04.2025

Numër Protokolli:2470/2025

A.nr.371/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.371/2025, të datës 26.02.2025, të parashtruar nga ankuesi L.S., kundër organit të punësimit/Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 14.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa me numër A.nr.371/2025, e datës 26.02.2025, të parashtruar nga ankuesi L.S.

A r s y e t i m

Ankuesi L.S.(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), me datë 26.02.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1287/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN00015512, të shpallur më datë 17.10.2024 nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, gjegjësisht për pozitën e punës “*Drejtor Ekzekutiv*” në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin për të Rritur. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ndërsa kjo e fundit, më datë 01.04.2025 ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e datës 26.02.2025, e parashtruar nga ankuesi, **është e pasafatshme**, sepse:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, më datë 17.10.2024 ka shpallë Konkursin me numër reference RN00015112, për pozitën e punës “*Drejtor Ekzekutiv*” në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin për të Rritur, ku afati për aplikim ka qenë nga data 18.10.2024 deri më 16.11.2024.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës, rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë tetëmbëdhjetë (18) kandidatë, ndërsa prej tyre kriteret i kanë plotësuar dhe kanë vazhduar me fazat e vlerësimit profesional shtatë (7) kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesi i cili i është nënshtruar vlerësimit të testit me shkrim dhe intervistës me gojë ku ka arritur gjithsejtë 79 pikë të përgjithshme nga kjo procedurë rekrutimi.

Organi përkatës i punësimit, me datë 20.12.2024 ka nxjerrë Njoftimin lidhur me renditjen përfundimtare të kandidatëve për pozitën e punës “*Drejtor Ekzekutiv*” në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin për të Rritur, i cili edhe është publikuar në SIMBNJ më datë 23.12.2024, nga i cili njoftim rezulton se kandidatja F.Z. me gjithsejtë 92 pikë (45.8 nga testi me shkrim dhe 46.2 nga intervista me gojë) pikë të arritura, është renditur si kandidatja fituese me më së shumti pikë të arritura, para ankuesit dhe kandidatit fitues E.G i cili ka arritur 70.2 të përgjithshme nga kjo procedurë rekrutimi.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se është diskriminuar kundrejt kandidatëve tjerë ngase sipas tij ftesa për intervistë i është dërguar një ditë pas kandidatëve tjerë, duke deklaruar ndër të tjera se nuk i është lejuar qasja në testin me shkrim si dhe ka theksuar se kandidatja e parë në listë me më pas se dy vite del në pension ndërsa njoftimi është shpallur në SIMBNJ më datë 30.01.2025.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmerinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publike të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, gjegjësisht nenit 47 paragrafi 10 ku përcaktohet se: *10. Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative.*, nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *17. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve.*, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 124 paragrafit 1, ku përcaktohet se: *1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...*, ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.*, dhe si rrjedhojë duke bazuar në kuadrin përkatës ligjor si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës Kolegji konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është e pasafatshme, ngase ashtu sikurse u tha me lartë në arsyetim të këtij vendimi, rezultati përfundimtar është publikuar me datë 23.12.2024, ndërsa ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.02.2025, nga rrjedh se ankesa është parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me dispozitat e nenit **127 paragrafi 1** të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si e tillë është e pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të hedhë poshtë ankesën si të pasafatshme, të filluar sipas ankesës me numër A.nr.371/2025 të datës 26.02.2025, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.371/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit L.S.;
- Udhëheqëses së Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.